



NJOFTIM PËR MEDIA MBI MBLEDHJEN E AMA-S DATË 29.03.2016

Ditën e martë, më datë 29 Mars, 2016 u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive në të cilën morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Z.Gentian Sala	Kryetar
Z.Sami Nezaj	Zëvendëskryetar
Z.Gledis Gjipali	Anëtar
Z.Piro Misha	Anëtar
Zj.Suela Musta	Anëtar
Z.Zylyftar Bregu	Anëtar

AMA në përputhje me rendin e ditës, miratoi vendimet e mëposhtme:

1. Miratimin e tarifave për mbështetjen e operatorëve privat vendor në rrjetin numerik të ndërtuar nga RTSH.
2. Miratimin e bilancit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2015.
3. Heqjen e licencës së shoqërisë “Alsat” sh.p.k., për televizionin satelitor “Tv Alsat”.
4. Heqjen e autorizimit lëshuar për shoqërinë “Sky Digital” sh.p.k., autorizuar me shkresën përcjellëse nr. 528 prot., datë 11.03.2014 për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Sky Digital”.
5. Heqjen e licencës së shoqërisë “Veçiku” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Tv Veçiku”.
6. Heqjen e autorizimit lëshuar për shoqërinë “Apollnet” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Apollnet”.
7. Heqjen e autorizimit lëshuar për subjektin person fizik Rruzhdin Bajrami, autorizuar për përsëritjen e programeve të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Bajrami Net”.
8. Konstatimin e pavlefshmërisë të licencës së shoqërisë “Përmeti” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Tv Përmeti”.
9. Konstatimin e pavlefshmërisë të licencës së shoqërisë “Tv 11” licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Tv Riviera”.
10. Konstatimin e pavlefshmërisë të licencës së subjektit person fizik Arjan Sotiri licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Tv 2A”.
11. Konstatimin e pavlefshmërisë të licencës së subjektit person fizik Arben Caka licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Tv 7”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

12. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit lëshuar për shoqërinë “Cable Albania Kombi” sh.p.k për subjektin “Cable Albania Kombi”.
13. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Kombi” sh.p.k., për subjektin “Tv Kabllor Kombi”.
14. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit lëshuar për shoqërinë “Cable Albania Shkodër” sh.p.k. autorizuar për subjektin “Cable Albania Shkodër”.
15. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së subjektit person fizik Arben Caka, licencuar për subjektin audioviziv privat vendor “Tv Era”.

16. Për subjektet:

- Shoqëria “Envo Company” sh.p.k., autorizuar për subjektin “TV kabllor Envo Company”; (shlyer një pjesë të detyrimit financiar),
- Shoqëria “Media 99” sh.a., të licencuar për subjektin oshma “TV Koha”;
- Personi fizik Anduel Shabani autorizuar për subjektin oshma “Ca-Tv Përmeti”;
- Shoqëria “Mishel” sh.p.k. licencuar për subjektin oshma “Tv 4+”; (shlyer një pjesë të detyrimit financiar),
- Shoqëria “Margit Tv” sh.p.k., të licencuar për subjektin oshma “ Tv Margit”; (shlyer një pjesë të detyrimit financiar),
- Shoqëria “TV Kombi” sh.p.k. autorizuar për subjektin “Tv Kombi”; (shlyer një pjesë të detyrimit financiar),
- Shoqëria “6+1 Vlora” SH.P.K., të licencuar për subjektin oshma “Tv 6+1”; (shlyer një pjesë të detyrimit financiar),
- Shoqëria “Fokus Tv” për subjektin oshma “Tv Focus”; (shlyer një pjesë të detyrimit financiar),
- Shoqëria “Vlora Channel” sh.p.k., për subjektin oshma “Vlora Channel”. (shlyer një pjesë të detyrimit financiar),

nga të cilët një pjesë iu përgjigj ftesës së Autoritetit të Mediave Audiovizive për pjesëmarrje përpara marrjes së vendimit përfundimtar për konstatimin e pavlefshmërisë/heqjes së licencës/autorizimit, dhe një pjesë kanë shlyer pjesërisht detyrimet financiare financiare, **AMA vendosi** shtyrjen e afatit për **shlyerjen e plotë** të detyrimeve financiare pagesë vjetore për licencë/autorizim.

17. Për subjektet :

- Shoqëria “Avn” sh.p.k. licencuar për subjektin oshma “Tv Avn”;
- Shoqëria “Tv Teknomedia” sh.p.k., për subjektin oshma “Nesër tv”;
- Shoqëria “Amantia Tv” sh.p.k., të licencuar për subjektin oshma “Tv Amantia”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

të cilët kanë shlyer detyrimin e plotë financiar pagesë vjetore për licencë/autorizim, AMA vendosi **pezullimin** e procedurës për konstatimin/heqjen e licencës.

Po ashtu u zhvillua intervista me kandidatët për pozicionet Kryetar dhe Anëtar të Këshillit të Ankesave dhe u vendos marrja e vendimeve për zgjedhjen e tyre në takimin e radhës së anëtarëve të AMA-s.

Duke konsideruar numrin e çështjeve të rendit të ditës, AMA vendosi të vazhdojë me shqyrtimin e çështjeve të tjera të mbetura nga rendi i ditës në mbledhjen e ardhshme në datë 4 Prill 2016.

Tiranë, 29 Mars 2016

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE